



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
FONDI I SIGURIMIT SHËNDETËSOR FOND ZA ZDRAVSTVENO OSIGURANJE HEALTH INSURANCE FUND	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Data Datum Date
FSSH	786
- 1 -	050424
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA	


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravlja – Ministry of Health
Fondi për Sigurime Shëndetësore – Fond Zdravstvenog Osiguranja – Health Insurance Fund
Bordi Drejtues – Upravni Odbor – Steering Board

Nr.04/10
Prishtinë, datë: 3 prill 2024

Në mbështetje të Nenit 32, paragrafi 1 nen-paragrafi 1.1.2 të Ligjit Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-042, si dhe neni 7 i Statutit të Fondit për Sigurim Shëndetësor. Bordi Drejtues i Fondit për Sigurim Shëndetësor, në mbledhjen e mbajtur me datë 03 prill 2024 merr:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti Vjetor i Punës së Fondit për Sigurim Shëndetësor për vitin 2023.
2. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Arben Vitia
Kryesues i Bordit Drejtues të FSSH-së

Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit Drejtues të FSSH-së;
- Sekretarisë së Bordit Drejtues të FSSH-së dhe
- Arkivit të FSSH-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë – Ministarstvo Zdravlja – Ministry of Health
Fondi për Sigurime Shëndetësore – Fond Zdravstvenog Osiguranja – Health
Insurance Fund

RAPORTI VJETOR I PUNËS
FONDI PËR SIGURIM SHËNDETËSOR
JANAR - DHJETOR
2023



TABELA E PËRMBAJTJES

1. Hyrje	3
2. Sistemi i kontrollit të brendshëm	4
2.1. Divizioni Ligjor	4
2.2. Komunikimi dhe raportimi	4
3. Auditimi i brendshëm	5
3.1. Burimet njerëzore	5
3.2. Divizioni për Informim dhe Bashkëpunim	6
4. Buxheti	7
4.1. Shpenzimet	8
4.2. Prokurimi	10
4.3. Pasuritë	10
4.4. Trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJIShP)	11
4.5. Procesi i barazimeve me institucionet shëndetësore	12
5. Sistemi i Informimit Shëndetësore (SIF)	13
6. Shërbimet Farmaceutike	13
7. Shërbimet Shëndetësore	14
8. Sfidat	15



1 Hyrje

Ligji për Sigurim Shëndetësor Nr. 04/L-249, neni 32 përcakton: *Bordi Drejtues shqyrton raportet e rregullta vjetore dhe tre (3) mujore me deklaratën financiare, raportet e auditimit, si dhe raportet plotësuese mbi aktivitetin e Fondit.*

Bazuar në këtë, është hartuar raporti vjetor së bashku me deklaratën financiare¹ si dhe raportet plotësuese mbi aktivitetet e realizuara të Fondit.

Planifikimi i aktiviteteve është bërë duke marrë parasysh të gjitha burimet me të cilat disponon Fondi për Sigurim Shëndetësor, përfshirë burimet njerëzore dhe ato financiare.

Në mungesë të Planit të punës për vitin 2022 Fondi për Sigurim Shëndetësor ka vazhduar me administrimin e programit për trajtim jashtë vendit si një ndër aktivitet kryesore.

Miratimi i planit të punës për vitin 2023 do të kontribuojë në realizimin e misionit të Fondit i cili është krijimi i qëndrueshmërisë financiare dhe blerja e shërbimeve shëndetësore.



2. Sistemi i kontrollit të brendshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm në Fond mundëson kontrolle efikase për adresimin e rreziqeve dhe ofrimin e sigurisë së arsyeshme lidhur me arritjen e rezultateve në realizimin e objektivave të Fondit.

2.1. Divizioni Ligjor

Divizioni Ligjor gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023 ka vazhduar në ofrimin e shërbimeve profesionale që bien në fushëveprimin e tij. Gjatë vitit, janar- dhjetor janë pranuar gjashtë (6) padi, nga të cilat pse (5) padi janë ushtruar me kërkesën për kompensimin të shpenzimeve të trajtimit në kuadër të programit për TMJIShP, ndërsa një (1) padi është me kërkesën për kompensimin e mjeteve nga marrëdhënia e punës.

Gjithashtu për periudhën tetor- dhjetor janë pranuar 12 ankesa nga kundër vendimeve të Bordit për TMJIShP, nga Komisioni i ankesave, ku 5 nga këto ankesa janë refuzuar, ndërsa 7 prej tyre janë aprovuar.

Po ashtu, ka ofruar ndihmë profesionale përmes bashkëpunimit me Zyrën e Avokaturës Shtetërore në kontestet gjyqësore ku palë ka qenë Fondi.

Në të njëjtën kohë, gjatë këtij vitit ka mbajtur kontakte të rregullta me Divizionin Ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me Planin Legjislativ 2022 si dhe ka marrë pjesë në shumë komisione dhe grupe tjera të emëruara nga Drejtori që kanë të bëjnë me çështje të rekrutimit, disiplinimit dhe ankesave.

2.2. Komunikimi dhe raportimi

Në funksion të organizimit dhe menaxhimit efikas, drejtuesit e Fondit në praktikat e punës dhe administrimit kanë instaluar praktika organizative që mundësojnë planifikim, bashkërendim dhe mbikëqyrje efikase. Në aspektin e komunikimeve të brendshme, Fondi ka ndërtuar një komunikim efektiv me punonjësit, duke ofruar mundësi për secilin punonjës të shprehet hapur si në nivelin hierarkik ashtu edhe brenda departamenteve për çështjet që lidhen natyrën e punës së tyre.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Fondit mban takime të rregullta me udhëheqësit e departamenteve, në të cilat diskutohet dhe raportohet lidhur me aktivitetet operative të realizuara si dhe për aktivitetet e planifikuara për periudhën e ardhshme. Më pas, udhëheqësit e departamenteve



mbajnë takime me stafin e tyre të cilët informohen mbi çështjet kryesore lidhur me institucionin.

3. Auditimi i brendshëm

Bazuar në planin vjetor të auditimit për vitin 2023, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar të gjitha objektivat e parashikuara në planin e saj për vitin 2023.

Auditimet e përfunduara janë të bazuara në fushat me rrezik më të lartë, si:

- Menaxhimi i Arkivit;
- Trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore;
- Barazimet financiare me Institucionet Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore;
- Financat dhe Shërbimet e Përgjithshme.

Auditimet e brendshme kanë rezultuar me ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe për funksionimin sa më efikas në departamentet përkatëse.

Menaxhmenti pas pranimit të raporteve ka hartuar planet e veprimit dhe ka monitoruar proceset implementimit të rekomandimeve të dhëna.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka hartuar Planin Strategjik të NJAB 2024-2026 si dhe Planin Vjetor të auditimit për vitin 2024 i cili është bazuar në vlerësimin e rreziqeve.

3.1. Burimet njerëzore

Stafi i Fondit në fund të muajit dhjetor 2023 ishte në 41 punonjës, prej tyre:

- Në kuadër të Zyrës së Drejtorit të Fondit, 4 punonjës;
- Departamenti për Shërbime Shëndetësore, 8 punonjës;
- Departamenti për Shërbime Farmaceutike, 6 punonjës;
- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, 13 punonjës;
- Departamenti për Menaxhimin e Sistemeve të Informacionit, 1 punonjës;
- Divizioni për informim dhe bashkëpunim, 2 punonjës;
- Divizioni i Burimeve Njerëzore, 3 punonjës;
- Divizioni Ligjor, 2 punonjës;
- Divizioni i prokurimit, 1 punonjës;
- Njësia e Auditimit të Brendshëm, 1 punonjës.



Vlen të theksohet se në listën e pagave gjithashtu janë të përfshirë edhe 6 anëtarët e Bordit Drejtues.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, stafi i Divizionit për Burime Njerëzore ka vazhduar me menaxhimin e dosjeve, sistemit vijueshmërisë mbikëqyrjes e rregulloreve përkatëse, menaxhimin i peyroll-it, angazhime shtesë sipas kërkesave nga menxhmenti, si dhe ka organizuar trajnime vizita studimore, konferenca për stafin e Fondit kemi bashkëpunuar me Institutin e Kosovës për Administratë Publike nga lëmi të ndryshme.

Gjatë vitit kemi proceduar me konkursin për pozitën e punës Drejtor i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore proces që ka dështuar.

3.2. Divizioni për Informim dhe Bashkëpunim

Aktivitetet dhe kontributet për periudhe Janar-Dhjetor të Divizionit për Informim dhe Bashkëpunim janë të renditura si me poshtë:

- Komunikimi me media, përcjellja e informacioneve për të gjitha aktivitetet e Fondit, më qëllim të komunikimit dhe informimit, përmes kanaleve të shkruara dhe elektronike;
- Përgatitja e informacioneve të ndryshme për shtyp, seleksionimi dhe arkivimi i shkrimeve nga gazetatat, revistat dhe shkrimet e ndryshme që kanë të bëjnë me Fondin;
- Publikimi i vazhdueshëm i dokumenteve me rëndësi për Fondin dhe konkurseve në WEB faqen e institucionit;
- Mirëmbajta e vazhdueshme e rrjetit social Facebook, mjet jashtëzakonisht i rëndësishëm për komunikim dhe informim të opinionit.
- Trajtimi i të gjitha kërkesave (pyetjeve) të pacienteve që kërkojnë mbështetje financiare nga programi për Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike dhe qasje e lehtë e tyre në informacione, duke shërbyer si urë lidhëse në mes pacienteve (familjarëve të tyre) dhe departamenteve të caktuar brenda Fondit;
- Mirëmbajta e vazhdueshme e rrjetit social Facebook, mjet jashtëzakonisht i rëndësishëm për komunikim dhe informim të opinionit.

4. Buxheti

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Buxheti i ndarë për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore ishte 8,938,806€.

Tabela 1. Ndarjet buxhetore të Fondit për vitin 2023

Kategoritë ekonomike	Administrata	Trajtimi Mjekësor Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore	Trajtimi për Viktimat e Dhunës Seksuale. Luft. Fundit	Gjithsej buxheti për vitin 2023
Paga dhe mëditje	413,806			413,806
Mallra dhe Shërbime	500,000			500,000
Shpenzime komunale	25,000			25,000
Subvencionet dhe transfere		7,730,000	270,000	8,000,000
Shpenzimet kapitale	-			-
Gjithsej	938,806	7,730,000	270,000	8,938,806

Nga Tabela nr. 1 mund të shihet se nga gjithsej buxheti fillestar për vitin 2023 në vlerë 8,938,806, vlera prej 7,730,000€, ose 86% e totalit të buxhetit, ishte ndarë për subvencione dhe transfere, përkatësisht për programin Trajtimi Mjekësor Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore, ndërsa pjesa tjetër për Trajtimi për Viktimat e Dhunës Seksuale gjate Luftës se Fundit dhe shërbimet administrative të Fondit.

Buxheti fillestar i ndarë për vitin 2023 për Trajtime Mjekësore Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike në shumë prej 7,730,000€ nuk mbulonte detyrimet kontingjente që rrjedhin nga fletëzotimet e lëshuara nga Drejtori i Fondit si, dhe vlera e aplikimeve të rregullta që pritet të aprovohen nga Bordi për Trajtime Mjekësore Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike e mbetura në fund të vitit 2022 për këtë program, të cilat ishin 31,634,943.46€.

Kjo vazhdon të jetë sfidë për Fondin, pasi për çdo vit kalendarik për programin e Trajtimeve Mjekësore Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike aplikojnë rreth 1000 pacientë dhe mesatarja e shpenzimeve për shkak të referimeve të shumta nga klinikat e ShSKUK-s është shumë më e lartë në raport me ndarjet buxhetore për këtë program. Kjo ka shkaktuar që detyrimet e Fondit për këtë program të rriten nga viti në vit.

Megjithatë, Fondi kishte deklaruar kursime në vlerë totale 515,000€ (Trajtimi për Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës se Fundit në Kosovë, kategorisë subvencionet dhe transfere në vlerë 270,000€, mallra dhe shërbime në vlerë 245,000€) të cilat kishe transferuar, përkatësisht në programin Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike.

Me vendimin e Qeveris së Republikës së Kosovës, me nr. 27/178 të datës: 13.12.2023 për ndarjen e mjeteve buxhetore, Fondit janë alokuar fonde në shumë 15,000,000€, në kategorinë subvencione dhe transfere në programin Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike.

Pas ndryshimeve buxhetore me vendimin e Qeverisë, buxheti i Fondit është rritur për 15,000,000€. Buxheti final pas ndryshimeve është paraqitur në tabelën në vijim.

Tabela nr.2. Buxheti final i Fondit për vitin 2023

Kategoritë ekonomike	Administrata	Trajtimi Mjekësor Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore	Gjithsej buxheti për vitin 2023
Paga dhe mëditje	396,198		396,198
Mallra dhe Shërbime	255,000		255,000
Shpenzime komunale	25,000		25,000
Subvencionet dhe transfere		23,245,000	23,245,000
Shpenzimet kapitale	-		-
Gjithsej	676,198	23,245,000	23,921,198

4.1. Shpenzimet në raport me buxhetin final


Tabela nr.3. Shpenzimet në raport me buxhetin final për vitin 2023

Kategoritë ekonomike	Buxheti fillestar	Buxheti final	Shpenzimet 2023	Realizimi i buxhetit në %
Paga dhe mëditje	413,806	396,198	396,198	100%
Mallra dhe Shërbime	500,000	255,000	223,486	88%
Shpenzime komunale	25,000	25,000	16,298	65%
Subvencionet dhe transfere	8,000,000	23,245,000	22,075,171	95%
Shpenzimet kapitale	-	-	-	-
Gjithsej	8,938,806	23,921,198	22,711,152	95%

- **Paga dhe mëditje**- Buxhetin fillestar i aprovuar ishte 413,806.0€, mirëpo në buxhetin final kjo kategori ishte zvogëluar në 396,198.0€. Në fund të vitit buxheti i realizuar ishte 396,198.0€, ose shprehur në përqindje në 100%;

- **Mallra dhe shërbime**– Buxheti fillestar i aprovuar për këtë kategori ishte 500,000.0€, mirëpo me vendime ky buxhet ishte ulur për 245,000€, duke reduktuar vlerën e buxhetit final në 255,000.0€. Buxheti final i shpenzuar ishte 223,486.0€, ose shprehur në përqindje në 88%;
- **Shpenzimet komunale**- Buxhetin fillestar i aprovuar për këtë kategori ishte 25,000.0€, buxheti final ishte i njëjtë në 25,000.0€. Buxheti i realizuar në fund të vitit për këtë kategori ekonomike ishte 16,298.0€, ose shprehur në përqindje 65%;
- **Subvencione dhe transfere**- Buxhetin fillestar i aprovuar për këtë kategori ishte 8,000,000.0€, mirëpo buxheti final ishte rritur për 15,245,000€, duke rritur vlerën e buxhetit final në 23,245,000.0€. Buxheti final i shpenzuar ishte 22,075,171.0€, ose shprehur në përqindje 95%; dhe
- **Shpenzimet kapitale**– Nuk ka pasur ndarje buxhetore për këtë kategori.

Figura nr.1. Shpenzimet në raport me buxhetin final për vitin 2023



Në kuadër të raportimit të Obligimeve vjetore pranë Ministrisë së Financave për kategorinë Subvencione dhe transfere, kemi përgatitur edhe raportin e Detyrimeve Kontingjente që rrjedhin nga aprovimet e Bordit, Fletëzotimet e lëshuara nga Drejtori i Fondit si dhe vlera e aplikimeve të rregullta që pritet të aprovohen nga Bordi për TMJISHP.

Tabela 4. më poshtë sqaron "Obligimet, aplikimet dhe pretendimet në bazë të Fletëzotimeve dhe rasteve të rregullta në kategorinë Subvencione.

Subvencione dhe Transfer - Obligimet dhe Detyrimet Kontingjente	Me 31 dhjetor 2023
Obligime në bazë të vendimeve të Bordit për TMJISHP	1,294,426.87 €
Vendimet e aprovuara nga Bordi në ritje të faturave	655,709.31 €
Fletë zotimet	10,609,790.83 €
Lende të rregullta në pritje për shqyrtim nga Bordi për TMJISHP	2,680,811.98 €
Gjithsej	15,240,738.98 €

Nga ndarjet buxhetore për këtë program ne raport me referimeve të shumta nga klinikat e SHSKUK-s ka shkaktuar që detyrimet e Fondit për këtë program të rriten nga viti në vit, por me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës: 13.12.2023 për ndarjen e mjeteve buxhetore në vlerë prej 15,000,000€, në programin Trajtim Mjekësor Jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike, Fondit ka arritur të zvogëlojë obligimet në krahasim me obligimet e vitit paraprak për këtë kategori.

Pasuritë

Për vitin 2023, janë krijuar komisionet për inventarizim të pasurisë dhe vlerësimin e pasurisë, në FSSH, të cilët pas procesit të identifikimit/numërimit fizik të pasurisë dhe vlerësimit të pasurisë, kanë hartuar raporte të cilat janë krahasuar me raportet e pasurisë për të identifikuar dhe eliminuar diferencat.

Prokurimi

Gjatë vitit 2023, Fondi ka zhvilluar dy procedura të prokurimit;

- Sigurimi i veturave TPL, TPL+ dhe Kasko për FSSH-ne,
- Mirëmbajtja Higjienike dhe Teknike e Objektivit të FSSH-së.

Ndërsa kontratat tjera si: furnizimi me derivate, mirëmbajtja e fotokopjeve, furnizimi me ujë të pijes etj., janë shfrytëzuar nga kontratat e centralizuara nga AQP-ja.

4.2. Trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike (TMJIShP)

Programi TMJIShP është program i themeluar me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në kushtet kur Institucionet Shëndetësore Publike nuk mund të ofrojnë shërbime të tilla. Këto shërbime kryhen në institucione shëndetësore private brenda ose jashtë vendit. Funksionimi i këtij programi është i rregulluar me Udhëzim Administrativ 03/2023 në të cilin janë të parapara procedurat e përfitimit nga ky program.

Në këtë program, gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2023, kanë aplikuar 1046 pacientë. Prej tyre, 315 raste urgjente dhe 731 raste elektive (të rregullta).

Tabela 4. Kërkesat dhe lëndët e aprovuara për periudhën Janar- Dhjetor 2023 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2022

Nr.	Përshkrimi	Janar- Dhjetor 2022	Janar- Dhjetor 2023	Diferenca
1	Aplikime	1099	1046	(53)
2	Raste urgjente	524	315	(209)
3	Raste të rregullta	575	731	(156)
4	Aprovime	672	1621	(949)

Tabela 5. Aplikimet sipas klinikave, në periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2023 në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2022

Nr.	Klinika	Nr. i aplikimeve Janar- Dhjetor 2022	Nr. i aplikimeve Janar- Dhjetor 2023	Diferenca
1	Oftalmologji	82	77	(5)
2	Pediatri	145	165	20
3	Hematologji	117	122	5
4	Ortopedi	132	77	(55)
5	Kirurgji torakale	23	23	0
6	Onkologji	8	8	0
7	Neurologji	41	24	(17)
8	Neurokirurgji	42	35	(7)
9	ORL	42	39	(3)
10	Urologji	52	23	(29)
11	Gastroenterologji	5	13	8
12	Kardiologji	22	11	(11)
13	Neonatalogji	36	18	(18)
14	Mjekësi nukleare	71	237	166
15	Nefrologji	25	25	0
16	Kirurgji vaskulare	16	13	(3)

17	Pulmologji	5	3	(2)
18	Radiologji	156	57	(99)
19	Kirurgji abdominale	5	8	3
20	Te tjera	45	68	23
Gjithsej		1098	1046	(52)

Procesi i barazimeve me spitalet private

Me vendimin e datës 23 shkurt 2019, Drejtori i Fondit ka themeluar Komisionin për Barazime Financiare ndërmjet Fondit dhe Institucioneve Shëndetësore Private brenda dhe jashtë vendit. Sipas vendimit, komisioni ka për obligim që të marrë në shikim, kontrolloj, dhe verifikoj tërë dokumentacionin në lidhje me secilën kërkesë individuale për programin TMJIShP, pavarësisht vendit ose kohës së realizimit të kërkesës. Dokumentacioni i pranuar verifikohet kundrejt të dhënave dhe informatave që komisioni ka në dispozicion dhe/ose do të pranoj nga ISHP-të brenda dhe jashtë vendit.

Procesi i barazimeve vazhdon deri në përmbylljen e barazimeve me të gjitha institucionet shëndetësore ku shtetasit e Kosovës kanë marr shërbimet e nevojshme shëndetësore.

Për periudhën Janar- Dhjetor 2023 janë barazuar 15 institucione shëndetësore private me 534 transaksione dhe vlera e mjeteve të lira të dala nga ky proces është 415,169€. Nga 15 institucione me raporte, 1 prej tyre nuk ka pranuar nënshkrimin e raportit.

Komisioni për barazime financiare ka përgatitur dhe nënshkruar raport për secilin institucion shëndetësor private të cilat kanë pranuar mjeteve financiare nga Fondi dhe njëti i është dërguar menaxhmentit.

Pas pranimit të raportit, menaxhmenti i Fondit ka iniciuar shkresa drejtuar institucioneve shëndetësore private me kërkesa për kthimin e mjeteve të lira në Llogarinë Kryesore– BK.

Prej 15 institucioneve të barazuar në vitin 2023, një (1) prej tyre ka bërë kthimin e mjeteve në vlerë prej 23,000€, ndërsa 14 prej tyre janë në proces të njoftimit për kthimin e mjeteve të lira, pavarësisht se me parë janë njoftuar për kthimin e mjeteve. Në vijim kemi prezantuar detajet për secilin prej tyre.

Tabela nr.7 Institucionet Shëndetësore Private me të cilat Fondi ka përfunduar barazimet në vitin 2023

Nr	Institucioni Shëndetësor Privat	Numri i shërbimeve	Vlera totale e pagesave	Vlera e mjeteve të lira
1	Prolab sh.p.k.	7	5,138	260
2	Tirana Lab	10	3,813	900
3	Klinika Gjermane e Syrit sh.p.k.	28	48,980	4,450
4	Homelab Pluse	1	1,200	-
5	Ortoprotech	1	5,684	36
6	Laboratori Norma	2	980	-
7	Trimed Klinik	1	630	-
8	O.P.S. Implant Dent	1	700	-
9	Spitali Otrila	5	43,300	23,000
10	Laboratori E-Lab	14	31,690	4,112
11	Hygeia Hospital - Tiranë	84	251,681	45,335
12	Ortoprotech	9	83,014	-
13	Spitali Aloka	1	6,300	-
14	Spitali Amerikan - Tiranë	312	2,248,071	334,276
Gjithsej		476	2,731,181	412,369

Tabela nr 8: Institucionet Shëndetësore Private me të cilat Fondi ka përfunduar barazimet në vitin 2023, por nuk kanë pranuar nënshkrimin e raportit.

Nr	Institucioni Shëndetësor Privat	Numri i shërbimeve	Vlera totale e pagesave	Vlera e mjeteve të lira
1	Qendra Laserike e Syrit - Kubati	58	105,560	2,800
Gjithsej		58	105,560	2,800

5. Sistemi i Informimit të Fondit (SIF)

Në kuadër të kësaj periudhe raportuese, Departamenti i Menaxhimit të Teknologjisë së Informacionit (DMTI) ka vazhduar realizimin e aktiviteteve të planifikuara dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe sistemeve të Teknologjisë Informative për funksionim sa më efikas drejt kryerjes së shërbimeve dhe sigurimit të infrastrukturës së nevojshme harduerike për shfrytëzimin e aplikacioneve softuerike dhe sistemeve informative nga zyrtarët e Fondit, si dhe palët që shfrytëzojnë sistemet tona.

Në përgjithësi është bërë administrimi i sistemeve të informacionit, instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve të reja (Server, Switch, VoIP telefon, Desktop PC, UPS), mirëmbajtja dhe



menaxhimi i pajisjeve harduerike dhe softuerike si dhe menaxhimi i adresave të email-ave për stafin.

Mirëmbajtja e ndërlidhjeve të Sistemit të Informimit të Fondit me sisteme të institucioneve të tjera ka vazhduar dhe janë përditësuar të dhënat e regjistrave.

6. Shërbimet Farmaceutike

Në kuadër të periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2023, Departamenti për Shërbimet Farmaceutike ka realizuar aktivitetet e prezantuara si në vijim:

- Hartimi dhe finalizimin i Projektligjit për Çmimin e Produkteve medicinale;
- Hartimi dhe finalizimi i Planit të Veprimit për implementimin e Ligjit për Çmimin e Produkteve medicinale;
- Pjesëmarrje aktive në grupe punues për hartimin dhe finalizimin e Udhërrëfyesve dhe Protokolleve Klinike Kombëtare;
- Pjesëmarrje në grup punues për identifikimin e rreziqeve; hartimin e Rregulloreve, Procedurave dhe Formularëve të nevojshëm për përdorimin e SIF;
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me Divizionin e Farmacisë pranë MSh-së rreth furnizimit me barna dhe material shpenzues nga Lista e Barnave Esenciale për nevojat e Institucioneve Shëndetësore të Kujdesit Parësor Shëndetësor;
- Pjesëmarrje aktive në komisionin për përcaktimin të çmimeve të produkteve medicinale të kontraktuara nga Ministria e Shëndetësisë;
- Pjesëmarrje aktive në Komitetin e Menaxhmentit të Lartë të Projektit të Shëndetësisë Kosovare;
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me Institucionet relevante, përfshirë këtu Agjencinë Kosovare për Produkte dhe Pajisje Medicinale (AKPPM) si dhe Odën e Farmacistëve të Kosovës (OFK) etj.

7. Shërbimet Shëndetësore

- Në kuadër të periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2023, Departamenti për Shërbime Shëndetësore ka realizuar aktivitetet e prezantuara si në vijim:



- Pjesëmarrja dhe kontributi në takimet e Këshillit Kosovar për Udhërrëfyes dhe Protokolle Klinike;
- Pjesëmarrja dhe kontributi në takimet e Grupit punues për fillimin e kampanjës vetëdijesuese të popullatës për rëndësinë e përzgjedhjes së mjekut familjar;
- Pjesëmarrja dhe kontributi në Grupin punues për vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë;
- Pjesëmarrja dhe kontributi në Grupin punues për monitorimin e kampanjës për zbatimin e planit të Veprimit për përcaktimin e kriterëve për regjistrin e banorëve në KPSh;
- Shqyrtimet e ankesave nga Komisioni i Ankesave të Fondit;
- Pjesëmarrja dhe kontributi në grupin punues të themeluar nga MSh në Finalizimin e Draft Ligjit për Sigurime Shëndetësore;
- Pjesëmarrja dhe kontributi në grupin punues të themeluar nga ZSP/MSh në Rishikimin dhe finalizimin e Udhëzimit Administrativ për Trajtim Mjekësor jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore;
- Pjesëmarrja dhe kontributi në kuadër të grupit punues për Hartimin e Planit vjetor të punës së Fondit për 2023;
- Pjesëmarrja dhe kontributi në kuadër të grupit punues për Hartimin e Raportit Vjetor të Fondit për vitin 2022;
- Hartimi i Planit të Veprimit për implementimin e Rekomandimeve nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm;
- Pjesëmarrja dhe kontributi në kuadër të Komisionit për Kostimin e Politikave (akteve nënligjore, strategjive, etj.) të themeluar me Vendim të ZSP;
- Pjesëmarrja dhe kontributi në grupin punues të themeluar nga MSh për plotësimin të Ligjit për Shëndetësi;
- Kontributi në grupin punues të themeluar nga MSh për Hartimin e Projektit të Bankës Botërore për Shëndetësi Pjesëmarrja dhe kontributi në Komisionin e themeluar nga MSh për Marrëveshjen e Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës me Ministrinë e Shëndetësisë të Republikës së Turqisë
- Pjesëmarrja dhe kontributi në Grupin punues të themeluar nga MSh për Programin për Reforma Ekonomike 2024-2026;

- Pjesëmarrja dhe kontributi në Komisionin e themeluar nga MSh për Hartimin dhe përditësimin e Kodit Ndërkombëtar të Diagnozave dhe Kodit Ndërkombëtar të Procedurave;
- Pjesëmarrja e rregullt në takimet koordinuese me menaxhmentin e FSSh;
- Takimet me palë si dhe me përfaqësues të institucioneve shëndetësore të përzgjedhura nga palët për të siguruar shërbimet e nevojshme mjekësore;

8. Sfidat

Ngritja dhe konsolidimi i Fondit të Sigurimit Shëndetësor është projekt multisektorial. Funksionalizimi varet nga shumë hisedar dhe atë: Ministrisë së Shëndetësisë, MPMS, MF, ARC, BQK, ATK, Komunave dhe Institucioneve shëndetësore të të gjitha niveleve. Secila nga këto institucione ka rolin e vet në funksionalizimin e Fondit dhe krijimin e sistemit të sigurimit shëndetësor. Prej gjithë hisedarëve, rolin thelbësor në funksionalizimin e Fondit e ka Ministria e Shëndetësisë si institucion politikë bërës.

Ndër sfidat kryesore të Fondit të Sigurimit Shëndetësor janë:

- Mungesa e kapaciteteve të nevojshme njerëzore;
- Miratimi i infrastrukturës së nevojshme ligjore e cila do të ndikonte në përafrimin e plotësimit të parakushteve për implementimin e skemës së sigurimeve shëndetësore;
- Trajnimi i vazhdueshëm i Stafit të Fondit;
- Referimet e shumta nga Klinikat e ShSKUK-s për trajtim jashtë vendit, jashtë listës së patologjive/procedurave;
- Mungesa e theksuar e buxhetit në kategorinë subvencione dhe transfere (Programi për TMJIShP), në raport me kërkesat për TMJIShP. Ky buxhet i ulët ka ndikuar në dëmtimin e imazhit dhe mosbesim ndaj Fondit si rezultat i pamundësisë për të përmbushur të gjitha kërkesat.
- Vonesat në miratimin e plotësim/ndryshimit të UA 03/2017 për TMJIShP. Përfundimi i këtij dokumenti do të korrigjonte shumë të meta të identifikuara në udhëzimin aktual e sidomos revidimin e listës së patologjive/procedurave mjekësore të cilat do të mbështeten financiarisht nga Fondi i Sigurimit.

Prishtinë, prill 2024